



BASHKIA
KORÇË

ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor

PLANI OPERACIONAL QENDRA KOMUNITARE KORÇË (QKK) 2020-2021



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës





BASHKIA
KORÇË

ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

PLANI OPERACIONAL QENDRA KOMUNITARE KORÇË (QKK)

2020-2021

Programi ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

**Një program i përbashkët i
Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

Koordinatorë vendorë, Bashkia Korçë:

Benila Themeli, Nënkryetare e Bashkisë
Ilir Zguri, Drejtor i Kujdesit Social

Ekspert:

Elona Dhembo

Redaktor:

Orsiola Kurti



Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Të gjitha palët që janë të interesuara për ta riprodhuar apo përkthyer të plotë apo pjesërisht këtë dokument, inkurajohen ta bëjnë diçka të tillë me autorizimin paraprak të Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Dizajni dhe printimi: Gent Grafik

Botuar nga programi ROMACTED
F-67075 Strasbourg Cedex
www.coe-romacted.org

www.coe.int
www.ec.europa.eu

©ROMACTED Programme, dhjetor 2020



Pasqyra e Lëndës

I. KONTEKSTI	7
II. VIZIONI I QKK	8
III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E QKK	9
IV. MJEDISËT DHE PERSONELI I QKK	11
IV.1 PERSONELI I QKK	12
V. PLANI I VEPRIMIT 2020-2021	15
VI. BURIMET FINANCIARE/PLANI FINANCIAR	20
VI.1 PLANI I TË ARDHURAVE	20
VI.2 PLANI I SHPENZIMEVE	21
SHTOJCË 1	22





I. Konteksti

Qendra Komunitare Korçë (QKK) është inaguruar në Janar të vitit 2015 si një Qendër Komunitare Ndërkulturore e ndërtuar përmes një bashkëpunimi mes Bashkisë Korçë dhe UNDP. Që në fillim të krijimit të saj, ajo pritej të adresonte një sërë problemesh me të cilat përballen pakicat e ndryshme në këtë Bashki, si “problemet ekonomike, kushtet e papërshtatshme të jetesës, problemet shëndetësore, arsimi publik, gjetja e një tregu pune dhe regjistrimi civil apo edhe probleme të tjera të rëndësishme sociale”¹.

Evidencat tregojnë se pakica të ndryshme pengohen në proceset e tyre integruese si pasojë e aksesit të munguar apo kufizuar në të mira dhe shërbime. Kjo lidhet ngushtë me sfida të tilla si varfëria, kushtet e vështira të jetesës, arsimim dhe kujdes shëndetësor të cunguar, akses i ulët në tregun e punës, e kështu me radhë. Në këtë kontekst, qendrat komunitare, si edhe QKK, lipset të funksionojnë me një qasje multi-dimensionale dhe ndërseksionale, duke u mundësuar grupeve të marginalizuara aksesin dhe bashkëpunimin me agjenci të ndryshme, shtetërore dhe private, si dhe një akses më të mirë në shërbime sociale më cilësore dhe të arritshme për këto komunitete.

Pak më shumë se 4 vjet nga hapja e saj, si dhe pas një sërë përvojash fillestare, Bashkia Korçë me mbështetjen e Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “ROMACTED: Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor” synon që përmes këtij dokumenti të ridimensionojë punën e QKKsë përmes një plani operacional, 2-vjeçar (2020-2021)², i cili do të shërbejë si një udhëzues për administrimin dhe veprimtarinë e Qendrës, si dhe do të integrojë në profilin e saj edhe rolin e një mekanizmi lehtësues edhe për zbatimin e Planit Social dhe Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, që Bashkia Korçë ka hartuar së fundmi.

1 Burimi: <http://bashkiakorce.gov.al/site/article.php?aid=973&t=Inagurohet-n%C3%AB-Kor%C3%A7%C3%AB->

2 Shënim: për pjesën e mbetur të vitit 2019 do të vijojë zbatimi i masave të parashikuara nga Bashkia Korçë për aktivitetin e QKK për këtë vit kalendarik.



II. Vizioni i QKK

Përmes Planit Social të saj, Bashkia Korçë ka si mision “të vendosë fokusin tek ofrimi i shërbimeve të standardizuara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat sociale në rritje, të grupeve në nevojë dhe pakicave”. Gjithashtu, Bashkia Korçë është angazhuar që për periudhën 2019-2022 të punojë në mënyrë të dedikuar “për nxitjen e gjithëpërfshirjes, multikulturalizmit dhe integrimin me të drejta të plota e të barabarta të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane...” siç artikullohet në vizionin e Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, 2019-2022. Në këtë kuadër, QKK pritet të ridimensionohet dhe të jetë një strukturë e rëndësishme brenda strukturave të qeverisjes vendore, e cila do të punojë për të përmushur vizionin e saj si:

Qendër Komunitare që operon me dhe për komunitetet në nevojë, në përfitim të tyre dhe të gjithë komunitetit të Bashkisë Korçë, në të cilin dekurajohet përjashtimi dhe nxitet dhe lehtësohet përfshirja e të gjitha grupeve të cenueshme dhe anëtarëve të tyre.



III. Qëllimi dhe objektivat e QKK

Në linjë me vizionin e saj, QKK ka si qëllim:

1. Të jetë e hapur dhe gjithëpërfshirëse në aktivitetin e saj për të gjitha komunitetet në nevojë dhe anëtarët e tyre, në linjë me çfarë specifikon kuadri politik dhe ligjor kombëtar, e veçanërisht planet vendore të Bashkisë (ai social dhe ai për integrimin e R&E);
2. Të lehtësojë dhe mundësojë akses në shërbimet sociale për pakicat në nevojë (shërbime të ofruara nga operatorë shtetërorë dhe privatë);
3. Të informojë dhe ndërgjegjësojë komunitetet në nevojë lidhur me mundësitë që ofrohen në bashkëpunim me ofrues të ndryshëm të shërbimeve në nivel vendor (si organizata jo-qeveritare, biznese sociale, institucione që ofrojnë mikro-kredi, qendra sociale etj.) lidhur me projekte, aktivitete dhe shërbime që promovojnë dhe mundësojnë përfshirjen sociale në këtë bashki;
4. Të zhvillojë procese gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrjen e komuniteteve për vlerësimin e nevojave dhe hartimin e planeve të veprimit për adresimin e tyre, si dhe të ndjekë zbatimin e planeve në bashkëpunim me aktorët e tjerë vendorë;
5. Të promovojë politikat dhe të ndihmojë në forcimin institucional të ndërrhyrjeve për përfshirjen sociale të komuniteteve në nevojë përmes ngritjes së kapaciteteve dhe ndihmës për institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore;
6. Të kujdeset, në mënyrë të veçantë, për zbatimin e dokumenteve politike strategjike për mundësi të barabarta dhe përfshirje sociale në vend (si në nivel kombëtar p.sh Strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale; Planin kombëtar për integrimin e romëve dhe egjiptianëve; Plani kombëtar për integrimin e personave me aftësi të kufizuar etj, ashtu edhe në nivel vendor – Plani Social dhe Plani për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane).



Për arritjen e këtyre qëllimeve, QKK nevojitet që në të dy vitet e ardhshme të punojë për përmbushjen e këtyre objektivave:

1. Të krijojë një profil të qartë dhe të fortë të lidërshpit vendor për çështjet e përfshirjes sociale dhe shanseve të barabarta;
2. Të krijojë bërthamën e nevojshme me burime njerëzore për të mundësuar zbatimin e planit operacional si dhe për të mundësuar ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të qendrës;
3. Të ndërtojë dhe forcojë një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me aktorë vendorë e më gjerë (si p.sh organizata jo-qeveritare, biznese, institucione qendrore dhe vendore etj), dhe të krijojë partneritete me to);
4. Të ndjekë/punojë për zbatimin e Planit Social dhe Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;
5. Të krijojë mundësi për projekte dhe aktivitete të tjera përmes shkrimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve.



IV. Mjediset dhe personeli i QKK

Qendra është një strukturë vendore në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Korçë. Si e tillë ajo mbështetet me mjedise dhe staf bërthamë nga Bashkia. Mjediset e QKK janë funksionale që nga viti 2015, por kanë nevojë për ndërhyrje riparuese. Struktura e personelit të qendrës është siç paraqitet në Figurën 4.1.




Figura 4.1. Struktura e personelit të Qendrës Komunitare Korçë



IV.1. Personeli i QKK

Organizimi i personelit të qendrës, siç vijon në këtë seksion, është një model fill-estar bazë, i cili mund të përshtatet sipas nevojave dhe mundësive, që krijohen gjatë aktivitetit të qendrës. Sugjerohet që optimalisht, qendra të ketë një menaxher, (të paktën) një koordinator terreni, një punonjës pastrimi dhe një punonjës sigurie. Megjithatë, në varësi të burimeve financiare në dispozicion dhe intensitetit të punës së Qendrës, stafi mund të zvogëlohet (për shembull pastrimi mund të mbulohet nga punonjës part-time apo punonjës të bashkisë që ditë të caktuara pune i dedikojnë për Qendrën; menaxheri në kohë vështirësish financiare mund të mbulojë edhe role të koordinatorit të terrenit, etj.).

4.1.1 Përgjegjësi (menaxheri) i QKK

Përgjegjësi i QKK është staf i përhershëm dhe përgjigjet për sigurimin e funksionalitetit të plotë të qendrës dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të saj.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për këtë anëtar të personelit të QKK përfshijnë:

- Garanton funksionalitetin e QKKsë në përputhje me planin e administrimit të qendrës, rregulloren e qendrës si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Menaxhon dhe koordinon veprimtarinë dhe aktivitetet e QKK me Bashkinë dhe të gjithë bashkëpunëtorët dhe partnerët, sipas nevojave;
- Raporton pranë Bashkisë për mbarëvajtjen dhe zbatimin e planit të QKK;
- Mbikqyr personelin e QKK;
- Përgjigjet për mbarëvajtjen dhe mosdëmtimin e asetëve fizike dhe financiare të qendrës;
- Ndërton dhe mban marrëdhënie profesionale dhe korrekte me komunitetet vendore, përfaqësuesit e tyre, me partnerë vendas dhe të huaj, sipas nevojave dhe mundësive që krijohen;
- Përgatit plane aktivitete (afat-mesme dhe afat-shkurtra) për veprimtarinë e Qendrës dhe ndjek zbatimin e tyre, pasi merr miratimin e autoriteteve të Bashkisë;
- Angazhohet në monitorimin e shërbimeve sociale që ofrohen nga partnerë të ndryshëm për grupe të synuara në fokus të aktivitetit të QKK;



Përgjegjësi i qendrës duhet të ketë këto kualifikime dhe aftësi bazë:

- Të ketë arsim të lartë në shkenca sociale; studimet pasuniversitare janë avantazh;
- Të ketë të paktën një përvojë pune 3 vjeçare si drejtues/menaxher në sektorin e administratës publike dhe/ose në atë të shoqërisë civile;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira për shkrim projektesh dhe ngritje fondesh.

Për një orientim më të plotë në rekrutimin e këtij personeli kyç për QKK është zhvilluar një përshkrim pune më i plotë si ai që gjendet në Shtojcë 1.

4.1.2 Koordinator i terrenit / specialist (1)

Qendra ka të paktën një koordinator terreni të përhershëm dhe punëson koordinatorë të tjerë (me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme) sipas numrit të projekteve të reja që fitohen dhe zbatohen prej saj.

Koordinatori i përhershëm i terrenit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Punon nën mbikqyrjen e përgjegjesit (menaxherit) të qendrës;
- Bën hartëzimin e aktorëve vendorë me interes për misionin dhe aktivitetet e QKK;

Krijon dhe mban marrëdhënie me një rrjet aktorësh (OJF, institucione, biznese etj) me të cilat lehtëson procesin e krijimit të partneriteteve në funksion të planit të veprimit të QKK;

- Zbaton në terren punën për mbledhjen e të dhënave; vlerësimin e nevojave; hartëzimin e komuniteteve në nevojë dhe të burimeve/aseteve të tyre; etj;
- Koordinon dhe ndjek zhvillimin e aktiviteteve brenda mjediseve të QKK;
- Informon dhe ndërgjegjëson komunitetet në nevojë lidhur me mundësitë që paraqiten për fuqizimin dhe integrimin e tyre;
- Kryen detyra të tjera që i ngarkohen nga menaxheri i QKK.



Koordinatori i terrenit duhet të ketë këto kualifikime dhe aftësi bazë:

- Të ketë arsim të lartë;
- T'i përkasë/përfaqësojë një prej komuniteteve në nevojë (p.sh komuniteteve rome, egjiptiane, PAK, etj.);
- Të ketë përvoja të mëparshme pune me komunitetet në nevojë;
- Të ketë shprehuri shumë të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri bazë të gjuhës angleze.

4.1.3 Punonjës pastrimi

Shërbimi i pastrimit sigurohet nga stafi i përhershëm i Bashkisë që mbulon këtë lloj detyre. Sipas planit dhe nevojave të QKK, Bashkia dërgon staf, që përgjigjet kryesisht për detyra të shërbimit bufetier dhe pastrimi, në veçanti:

- Përgjigjet për shërbimin bufetier në rastin e vizitorëve të veçantë në qendër;
- Përgjigjet për rregullin dhe pastërtinë në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të qendrës.

Në varësi të ngarkesës dhe numrit të projekteve që QKK fiton dhe zbaton, ajo mund të punësojë edhe një punonjës shërbimi bufetier dhe pastrimi me kohë të pjesshme apo të plotë, që mbulon ekskluzivisht mjediset e qendrës.



V. Plani i Veprimtimit 2020-2021

Objektivi	Strategjia për përmirësimin e tij	Veprimtaria/Aktivitetet	Koha
<p>1. Të krijohet një profil të qartë dhe të fortë të lidershipit vendor për çështjet e përfshirjes sociale dhe shanseve të barabarta.</p>	<p>Stafi i qendrës (më konkretisht përgjegjësi dhe koordinatori i terrenit) duhet të angazhohet menjëherë dhe intensivisht për ridimensionimin, njohjen dhe konsolidimin e profilit të QKK si një entitet lider vendor për shtyrjen përpara të politikave dhe proceseve që nxisin dhe garantojnë përfshirjen sociale dhe shanset e barabarta. Ata dhe, përmes tyre, QKK duhet të bëhen të njohura për komunitetin e Bashkisë Korçë dhe aktorët vendorë e më gjerë. Në veçanti, ata duhet të njihen, krijojnë raporte dhe t'i konsolidojnë ato me komunitetet në nevojë.</p>	<p>1.1 Hartimi i një strategjie për prezantimin e QKK dhe stafit, njohjen e tyre nga aktorët vendorë e më gjerë, dhe njohjen me dhe nga komunitetet në nevojë.</p> <p>1.2 Hartimi i një plani pune për takime në terren – me aktorët relevantë dhe komunitetet në nevojë.</p> <p>1.3 Krijimi i një rrjeti institucionesh, organizatash dhe aktorësh të tjerë të rëndësishëm si bashkëpunëtorë apo partnerë në punën e qendrës.</p> <p>1.4 Hartimi i një strategjie PR-i / komunikimi për qendrën dhe punën e saj.</p> <p>1.5 Pjesëmarrje në mediet (kryesisht vendore por dhe më gjerë) përmes emisioneve sociale, kronikave informative, shkrimeve etj.</p> <p>1.6 Përdorimi i mediave vendore (TV, radio etj) dhe atyre sociale për ta bërë qendrën e njohur dhe për të qenë sa më pranë (edhe virtualisht) dhe ndërveprues me aktorët e rëndësishëm dhe me komunitetet e synuara.</p>	<p>Gijsma e parë e 2020</p> <p>Gijsma e parë e 2020</p> <p>Gijsma e parë e 2020</p> <p>Gijsma e parë e 2020</p> <p>Gijsma e parë e 2020</p> <p>Vazhdimisht 2020-2021</p> <p>Vazhdimisht 2020-2021</p>



Objekti	Strategjia për përmbushjen e tij	Vepërmataria/Aktivitetet	Koha
2. Të krijojë bërthamën e nevojshme me burime njerëzore për të mundësuar zbatimin e planit operacional, si dhe për të mundësuar ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të qendrës.	<p>Menjëherë pas rekrutimit të stafit të QKK nga Bashkia, drejtorja përkatëse si dhe vetë stafi i sapopunësuar angazhohen intensivisht për ndërtimin e strategjive, planeve dhe parashikimin e detyrave dhe aktiviteteve për ndërtimin dhe konsolidimin e kapaciteteve të stafit në funksion të misionit të qendrës. Staf i qendrës dhe Drejtorja e Kujdesit Social në Bashki, janë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm të punës dhe aktivitetit të tyre, në zbatim të "Planit Social" dhe "Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane" dhe në përgjithësi për nxitjen dhe mundësimin e përfshirjes sociale dhe shanseve të barabarta në këtë bashki.</p>	<p>2.1 Rekrutimi i stafit.</p>	Fillimi 2020 ³
		<p>2.2 Detajimi dhe dakordësimi i përshkrimeve të punës së anëtarëve të stafit.</p>	Fillimi 2020
		<p>2.3 Hartimi i rregullores së brendshme të qendrës.</p>	Fillimi 2020
		<p>2.4 Vlerësimi i nevojave dhe hartimi i planeve individuale dhe të stafit në tërësi për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të tyre.</p>	Gjysma e parë e 2020
		<p>2.5 Njohja e stafit bërthamë me kuadrin politik dhe legjislativ në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.</p>	Fillimi 2020
		<p>2.6 Njohja me hollësi dhe zbërthimi i "Planit Social" dhe "Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane" të Bashkisë Korçë</p>	Fillimi 2020
		<p>2.7 Ndarja e detyrave, marrja e përgjegjësiave dhe mirëkoordinimi i tyre brenda qendrës dhe me njësinë mëmë (Drejtorinë Sociale në Bashki), veçanërisht lidhur me zbatimin e "Planit Social" dhe "Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane" të Bashkisë Korçë.</p>	Fillimi 2020
<p>2.8 Identifikimi i mundësive dhe pjesëmarrja e stafit në aktivitete për ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të tyre (sipas planeve të zhvillimit – Planit Social, pika 2.3).</p>	Gjysma e parë e 2020, dhe në vijim		



Objektivi	Strategjia për përbushjen e tij	Veprimtaria/Aktivitetet	Koha
<p>3. Të ndërtojë dhe forcojë një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me aktorë vendorë e më gjerë (si p.sh organizata jo-qeveritare, biznese, institucione qendrore dhe vendore etj), dhe të krijojë partneritete me to.</p>	<p>Në funksion të njohjes dhe konsolidimit të qendrës dhe profilit të saj si njësi parësore vendore për çështjet e përfshirjes sociale, stafi i QKK ndërton dhe zbaton një strategji për krijimin e njohjeve, raporteve të bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorë vendorë e më gjerë, si dhe me persona kyç nga komunitetet e synuara.</p>	<p>3.1 Vlerësimi i nevojave dhe hartëzimi i aktorëve dhe burimeve në komunitete synuara (Një pikë nisjeje është lista e aktorëve dhe bashkëpunëtorëve të identifikuar në Planin Social të Bashkisë Korçë – Aneks 2)</p> <p>3.2 Mbajtja e aktiviteteve promovuese të qendrës me aktorët të ndryshëm (p.sh tryeza të rrumbullakta, workshopet etj.)</p> <p>3.3 Zhvillimi i takimeve me aktorë dhe persona kyç (veçanërisht organizata jo-ftimprurëse aktive dhe me fokus grupet e synuara).</p> <p>3.4 Identifikimi i donatorëve dhe mundësive për shtimin e mbështetjes dhe aktivitetit të qendrës.</p> <p>3.5 Krijimi dhe formalizimi (sipas rastit) i bashkëpunimeve/partneriteteve.</p>	<p>Gjysma e parë e 2020, dhe në vijim</p> <p>Gjysma e parë e 2020, dhe në vijim</p> <p>Gjysma e parë e 2020, dhe në vijim</p> <p>Gjysma e parë e 2020, dhe në vijim</p> <p>Gjysma e dytë e 2020, dhe në vijim</p>



Objekti	Strategjia për përmbushjen e tij	Veprimtaria/Aktivitetet	Koha
4. Të ndjekë / punojë për zbatimin e "Planit Social" dhe "Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane";	Qendra si strukturë e bashkisë me fokus përfshirjen sociale dhe shanset e barabarta, punon brenda kuartrit të dhe për realizimin e objektivave të "Planit Social" dhe "Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane". Për këtë ajo merr detyra dhe përgjegjësi specifike dhe koordinon me struktura dhe mekanizma të tjerë brenda Bashkisë.	4.1 Njeh me detaje dhe koordinon punën me struktura të tjera brenda bashkisë si me NJMF, punonjësimit/strukturën për barazinë gjinore, etj. që të mundësojnë zbatimin sa më efikas të planeve.	Gjysma e dytë e 2020, dhe në vijim
		4.2 Përfshihet dhe kontribuon në proceset vlerësuese të nevojave sociale dhe arritjes së objektivave të planeve. (Bashkëpunon ngushësisht edhe me strukturat/mekanismat për monitorim dhe vlerësim në Bashki).	Gjysma e dytë e 2020, dhe në vijim
		4.3 Merr pjesë në aktivitetet për ngritjen e kapacitetit të staft të Bashkisë për ofrimin e kujdesit shoqëror (Plani Social: Objektiv 2)	Vazhdimisht
		4.4 Zbaton dhe monitoron zbatimin e gjithë aktiviteteve të parashikuara në planin vendor të dedikuar për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane.	Vazhdimisht
		4.5 Ndjek, mbledh të dhëna dhe përgatit raporte fillestare monitorimi për shërbime sociale të kontraktuara së jashtmi nga Bashkia Korçë, prej të cilave përfitojnë grupet e synuara nga QKK.	Gjysma e dytë e 2020, dhe në vijim



Objektivi	Strategjia për përbushjen e tij	Vepri/taria/Aktivitetet	Koha
5. Të krijohet mundësi për projekte dhe aktivitete të tjera përmes shkrimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve.	Stafi i qendrës (kryesisht menaxheri i saj) ka kualifikimet dhe përvojën e domosdoshme për të mundësuar edhe shkrimin e projekteve dhe ngritjen e fondeve përmes bashkëpunimeve të ndryshme. Për këtë ai punon për identifikimin e këtyre mundësive dhe përgatit dhe aplikon vazhdimisht për grante/projekte të reja që fuqizojnë QKK dhe i lehtësojnë asaj përbushjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosur.	<p>1.1 Vendosija e raporteve dhe/ose ndjekja e aktiviteteve dhe njoftimeve të institucioneve dhe donatorëve më aktivë në fushë.</p> <p>1.2 Shkrimi dhe aplikimi i të paktën dy projekteve në vit.</p> <p>1.3 Pjesëmarrja në aktivitete për ngritjen e kapaciteteve në shkrim projekteve dhe ngritje fondeve.</p>	Vazhdimisht Vazhdimisht Vazhdimisht

3 Procesi i rekrutimit të staft mund të fillojë që në fundin e 2019, sipas parashikimeve për atë vit kalendarik.



VI. Burimet financiare/ Plani financiar

Qendra Komunitare Korçë mbështetet në veprimtarinë e saj me burime financiare parësore nga buxheti i Bashkisë Korçë. Megjithatë, qendra gjatë funksionimit të saj ka të drejtë të ngrëjë të ardhura të tjera nga:

1. Shkrimi i projekteve vendore e rajonale (si e vetme ose në partneritet);
2. Qeratë dhe tarifave mbi përdorimin e aseteve dhe shërbimeve që ajo ofron. Lloji dhe niveli i tarifave e qerave përkatëse miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Për këtë, QKK nevojitet të zhvillojë edhe një plan financiar dhe në varësi të të ardhurave të gjeneruara, të zgjerojë stafin (përfshirë edhe staf me profil financiar).

VI.1 Plani i të ardhurave⁴:

Të ardhurat nga:	Viti 2019 ⁴	Viti 2020	Viti 2021
Buxheti i Bashkisë Korçë	x	x	x
Aplikimet për projekte/grante	x	y	y+10%
Tarifat e përdorimit të mjediseve të qendrës (aty ku mund të aplikohen)	y	y+5%	y+10%
Donacione/ Filantropi	y	y	y+5%
Total			

4 Të ardhura të parashikuara për QKK para hartimit të këtij plani operacional.



VI.2 Plani i shpenzimeve:

Shpenzime:	Viti 2019 ⁴	Viti 2020	Viti 2021
Paga			
?			
?			
Total			

5 Të ardhura të parashikuara për QKK para hartimit të këtij plani operacional.



Shtojcë 1

Shembull përshkrim pune – Përgjegjësi (menaxheri) i QKK

Titulli: Përgjegjës i Qendrës Komunitare Korçë

Përgjigjet ndaj: Drejtuesit të Drejtorisë së Kujdesit Shoqëror, Bashkia Korçë

Përgjegjës për: Përgjegjësi i QKK është staf i përhershëm dhe përgjigjet për sigurimin e funksionalitetit të plotë të qendrës, mbarëvajtjen e aktiviteteve të saj dhe arritjen e objektivave të vendosura në kuadër të misionit të qendrës. Ai/ajo është përgjegjës edhe për koordinimin dhe mbikëqyerjen e punës së punonjësve të tjerë të QKK (qofshin ata me kohë të plotë, kohë të pjesshme apo vullnetarë/praktikantë).

Ngarkesa e punës: 25-40 orë në javë (në varësi të burimeve që keni në dispozicion) Nuk parashikohen pagesa për tejkalim orari, përveçse kur kjo dakordësohet me menaxherët e linjës, në kuadër të projekteve të fituara dhe mbështetura me grante të tjera dhe jo nga buxheti i Bashkisë Korçë. Në raste të veçanta, mund të kërkohet angazhimi në punë përtej orarit zyrtar apo në fundjavë, në varësi të aktivitetit të Qendrës, të dakordësuar më herët.

Qëllimi kryesor i këtij pozicioni:

Përgjegjësi apo menaxheri i Qendrës është një pozicion kyç në strukturën e QKKsë. Roli i tij/saj është shumëdimensional dhe përfshin detyra që shtrihen që nga pjesëmarrja dhe/ose drejtimi i proceseve planifikuese, vendimmarrëse, apo shkrimi i projekteve/granteve, deri në punë të natyrës ballë-për-ballë në takimet me aktorë të ndryshëm, veprimtari operacionale dhe administrative të qendrës, apo sigurimi mbarëvajtjes të aktiviteteve të përditshme të Qendrës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Garanton funksionalitetin e QKK në përputhje me planin e administrimit të qendrës, rregulloren e qendrës si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
- Menaxhon dhe koordinon veprimtarinë dhe aktivitetet e QKK me Bashkinë dhe të gjithë bashkëpunëtorët dhe partnerë, sipas nevojave;
- Raporton pranë Drejtorisë së Kujdesit Shoqëror, Bashkia Korçë për mbarëvajtjen dhe zbatimin e planit të QKK;



- Koordinon dhe mbikqyr personelin e QKK;
- Ndërton dhe mban marrëdhënie profesionale dhe korrekte me komunitetet vendore, përfaqësuesit e tyre, me partnerë vendas dhe të huaj, sipas nevojave dhe mundësive që krijohen;
- Përgatit plane aktivitete (afat-mesme dhe afat-shkurtra) për veprimtarinë e Qendrës dhe ndjek zbatimin e tyre, pasi merr miratimin e autoriteteve të Bashkisë;
- Angazhohet në monitorimin e shërbimeve sociale që ofrohen nga partnerë të ndryshëm për targetgrupe në fokus të aktivitetit të QKK;
- Përgjigjet për mbarëvajtjen dhe mosdëmtimin e aseteve fizike dhe financiare të qendrës;
- Detyra të tjera siç detajohen në përshkrimin e punës dhe/ose që mund t'i ngarkohen nga eprorët e tij.

Menaxheri i qendrës duhet të ketë këto **kualifikime dhe aftësi bazë**:

- Të ketë arsim të lartë në shkencë sociale; studimet pasuniversitare janë avantazh;
- Të ketë të paktën një përvojë pune 3 vjeçare si përgjegjës/drejtuës/menaxher në sektorin e administratës publike dhe/ose në atë të shoqërisë civile;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira për shkrim grantesh dhe ngritje fondesh.

Kapacitete, aftësi dhe cilësi të dëshirueshme:

- Motivim i lartë, vetbesim dhe lidhshmëri në orientimin, priorizimin dhe zbatimin e aktiviteteve;
- Përkushtim ndaj ndërtimit të aseteve dhe solidaritetit në komunitet duke respektuar dallimet;
- Aftësi shumë të mira komunikuese – me gojë dhe me shkrim;
- Aftësi shumë të mira organizative dhe lehtësuese;
- Njohuri të mira financiare;
- Mundësi për të qenë fleksibël me oraret e punës;
- Aftësi të mira kompjuterike (Microsoft Office përfshi Power Point, Word dhe Excel).

Shënim: Ky përshkrim pune nuk është definitiv dhe as kufizues. Ai është subjekt ndryshimi në varësi të mundësive dhe nevojave që krijohen në kohën e rekrutimit të stafit.







ROMANACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

www.eurora.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës